

**Njoftim për përqendrim me të cilin Allwyn International AG, Zvicër do të fitojë
kontroll të vetëm indirekt mbi SidePrize LLC, SHBA**

(lënda nr. 08-150 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 21.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është parashtruar njoftim për përqendrim me të cilin Allwyn International AG me seli të regjistruar në adresën Muhlenplatz 9, 6004, Lucern, Kantoni Lucern, Zvicër, do të fitojë kontroll të vetëm indirekt mbi SidePrize LLC me seli të regjistruar të veprimtarisë afariste në 1055 Howell Mill Road, Apartamenti 1400, Atlanta, Xhorxhia 30318 SHBA, përmes fitimit të pjesëve.

-Allwyn International AG është një shoqëri holding e themeluar në Zvicër, e cila fiton dhe menaxhon pjesë në kompani nga industria e lojërave të fatit dhe është shoqëria amë e Grupit Allwyn (Allwyn Group). Grupi Allwyn është një operator shumëkombësh i lotarisë me prani të ndjeshme në Austri, Republikën Çeke, Greqi, Qipro, Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Illinois), dhe i njëjti zotërohet përfundimisht nga Grupi KKCG (KKCG Group).

Grupi KKCG investon në disa fusha biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, patundshmëritë dhe teknologjitë informatike.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e operimit me terminale për video lotari dhe tregun e teknologjisë informatike, dhe ka këto shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut:

-CASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAKEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - veprimtari të bixhozit dhe basteve;

-Video lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë – Casinos Austria SHPK Shkup, me veprimtari prioritare - veprimtari të bixhozit dhe basteve;

-AVENGA SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm KINSHIFT SHPKNJP Shkup), me veprimtari prioritare - programim kompjuterik;

-AVENGA AKADEMI SHPKNJP Shkup (me emër të mëparshëm KINSHIFT AKADEMI SHPKNJP Shkup), me veprimtari prioritare - arsim tjetër, i papërmendur diku tjetër;

-MUSALA SOFT SHPKNJP Shkup, me veprimtari prioritare - programim kompjuterik.

Treg relevant për përqendrimin është tregu i sporteve fantazi (imagjinare) ditore në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të hulumtimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të parashtrojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

22.10.2025

Shkup